



Lezhë Buxheti i Qytetarit

Buxheti i Qytetarit: Transparencë në rritje dhe pjesëmarrje aktive në Bashkinë Lezhë

Manuali i Qytetarit

Mundësuar nga:



Ky manual është hartuar nga Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisjes pjesë e nismës “**LëvizAlbania** – Demokracia Vendore në Veprim”, falë mbështetjes financiare të Ambasadës Zvicerane në Shqipëri.

Ky botim u realizua me mbështetjen e LëvizAlbania. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht në qëndrimet e LëvizAlbania.

Autorët:

Arben Malaj

Arlind Rama

Ledjon Shahini

Aplikimet për lejen për të riprodhuar ose përkthyer të gjithë ose një pjesë të këtij manuali duhet të bëhen pranë zyrave të Institutit për Politika Publike dhe Mirëqeverisje ose pranë zyrave të LëvizAlbania, në adresat:

Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje

Rr. e Elbasanit nr.8, Shluj Luarsi, Kati 5-të

Tiranë, Shqipëri

Web: www.ippm.al

E-Mail: secretary@ippm.al

LëvizAlbania

Rr. Bardhok BibaGodina 12 kate -Mbrapa Hotel Tiranes

Nd. Trema, Hyrja B,Kati 9, Ap. 25

Tiranë, Shqipëri

E-Mail: info@levizalbania.al

Rreth Institutit për Politika Publike dhe Mirëqeverisje

Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje (IPPM) nisi si një iniciativë profesionale dhe akademike për të adresuar nevojën e rëndësishme për qeverisje të mirë në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, në shtator të vitit 2013, dhe është themeluar zyrtarisht në tetor të të njëjtit vit nga një grup akademikësh, profesionist të rinj dhe figura publike.

Misioni i IPPM-së është të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit publik për sfidat e qeverisjes së mirë nëpërmjet zhvillimit dhe promovimit të alternativave për një cilësi më të lartë të qeverisjes në sektorin publik dhe privat dhe për të siguruar angazhimin e tyre për qeverisje të mirë.

Objektivat e tij janë zhvillimi dhe promovimi i praktikave më të mira të mirëqeverisjes në sektorin publik dhe privat dhe nxitja e debatit publik për qeverisje të mirë, duke mbështetur reformat ekonomike që shërbejnë për procesin e integritetit evropian, duke sjellë së bashku në bashkëpunim grupe të ndryshme të interesit për një qeverisje të mirë, duke ndihmuar reformimin cilësor të sektorit publik dhe ngritjen e një procesi dialogu midis shumë palëve të interesuara rreth çështjeve në fjalë me një fokus kryesor në menaxhimin e financave publike. IPPM synon nxitjen e politikave efektive dhe masave administrative me më shumë transparencë në procesin e vendimmarrjes, dhe garantimin e lirisë së informacionit për qytetarët.

Rreth LëvizAlbania dhe nismës “Demokracia Vendore në Veprim”.

LëvizAlbania” është një projekt që synon të ketë një efekt katalizator për demokracinë vendore në Shqipëri përmes angazhimit të aktorëve të shoqërisë civile dhe individëve si kampionë të demokracisë.

LëvizAlbania për “demokracinë vendore” është vendimmarrje gjithëpërfshirëse dhe mbikëqyrje e qeverisjes vendore që sjell transparencë, përgjegjshmëri, gjithëpërfshirje dhe llogaridhënie më të madhe me qëllim arritjen e ofritit të shërbimeve publike të përmirësuara nga institucionet vendore. LëvizAlbania mbështet demokracinë vendore në të gjithë vendin nëpërmjet kultivimit të një shoqërie civile vendore me bazë në komunitet, që ka ndikim dhe nxit kërkesën për qeverisje të mirë. Në të njëjtën kohë, do të ndërmerren projekte strategjike dhe veprimtari advokacie në nivel kombëtar, për të mundësuar krijimin e një mjedisi që do të nxiste një demokraci vendore më të mirë dhe të qëndrueshme.

Tabela e Përmbajtjes

1. Buxheti dhe etapat e implementimit.....	9
1.1. Hyrje.....	9
1.2. Buxheti Vendor.....	10
1.3. Institucionet për përgatitjen dhe hartimin e buxhetit	11
1.4. Baza ligjore e procesit buxhetor.....	13
1.5. Parimet e buxhetimit.....	13
1.6. Funksionet e buxhetit	14
1.7. Fazat kryesore të procesit buxhetor.....	15
1.8. Kalendari i buxhetimit	16
2. Buxheti i Qytetarit	17
2.1. Çfarë është Buxheti i Qytetarit?.....	17
2.2. Rëndësia e Konsultimeve.....	18
2.3. Lobimi i grupeve të interesit	19
2.3.1. Rinia.....	19
2.3.2. Shoqëria Civile	20
2.3.3. Media	20
2.3.4. Komuniteti i Bizneseve	20
2.4. Perspektiva gjinore në shpërndarjen e burimeve.....	21
2.5. Roli dhe Ndikimi i Medias	22
2.5.1. Si mund, bashkitë, të mbështesin një angazhim aktiv dhe pozitiv të Medias?.....	24
3. Buxheti i Bashkisë Lezhë	24
3.1. Nga vijnë paratë e buxhetit?.....	24
3.2. Ku do shkojnë paratë e qytetarëve?	26
3.3. Numri i punonjësve të bashkisë për vitin 2016.....	27
4. Taksat Vendore dhe Platforma Financat vendore	28
4.1. Hyrje.....	28
4.2. Platforma Financat Vendore <i>www.financatvendore.al</i>	28
4.3. Taksat e Bashkisë Lezhë	28
4.3.1. Taksa e biznesit të vogël	29
4.3.2. Taksa mbi pasuritë e paluajtshme	29
4.3.3. Taksa e përkohshme për mbushje ose heqje dheu ne sipërfaqen truall	31

4.3.4. Tarifat vendore.....	31
4.3.5. Te ardhurat jo tatimore	32

Lista e Figurave

Figura 1: Hierarkia e institucioneve të përshfira në procesin e buxhetimit	12
Figura 2: Fazat e buxhetimit	15

Lista e grafikëve

Grafiku 1: Përbërja e të ardhurave	24
Grafiku 2: Planifikimi i Shpenzimeve sipas Programeve	27

Hyrje

Ky manual përmban në mënyrë të detajuar komponentët e një buxheti vendor duke synuar rritjen e kapaciteteve të qytetarëve në përgjithësi dhe grupeve specifike të interesit në veçanti mbi mënyrën sesi hartohet një buxhet, etapat që ai kalon si dhe këshilla se si mundet qytetarët të jenë aktiv në këtë proces. Manuali synon që të sigurojë një trajtim sa më të plotë dhe të kuptueshëm teorik të buxhetit të qeverisë qendrore duke u ndalur më së shumti në qeverinë vendore ku si rast konkret do të merret buxheti vendor i bashkisë së Lezhës, popullatës konkrete që ky manual synon.

Manuali ka për qëllim të përgatisë qytetarë me njohuri të mira në përgatitjen e një programi buxhetor vendor afatmesëm në mënyrë që të krijojë grupe aktive të cilat do të mund të jenë grupe qytetarësh të qendrueshme për të ndikuar në kohë cilësinë e jetës dhe shërbimeve që buxheti vendor duhet të mbaj parasysht në përgatitjen dhe implementimin e tij. Materiali përmban në trajtë të detajuar punën paraprake që duhet bërë dhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në zhvillimin e planit buxhetor të vitit pasardhës, në mënyrë që politikat vendore të ndërmerren në kuadër të një buxhetimi sa më produktiv dhe në shërbim të interesave publike qytetarëve. Ky material përmban gjithashtu shembuj ilustrativë si dhe çështje konkrete që lidhen me përfaqësimin e grupeve të interesit në buxhetimin vendor si barazia gjinore, rinia, Shoqëria civile, bizneset, etj.

Manuali është hartuar e artikuluar në një gjuhë sa më të thjeshtë në mënyrë që të mund të kuptohet nga të gjitha grupet e lexuesve, duke u bërë të qartë procedurat dhe etapat që ndiqen në një buxhetim vendor, si dhe në monitorimin e tij.

Përse një trajnim për buxhetin e qytetarit?

Një element i rëndësishëm i cilësisë së buxhetimit është transparenca e këtij procesi, lehtësimi dhe inkurajimi i përfshirjes së shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në çdo fazë të tyre. Kjo jo vetëm përmirëson procesin politik-bërës për strategjitë dhe reformat kryesore por, nëpërmjet një pjesëmarrje aktive të taksapaguesve dhe përfituesve nga politikat buxhetore, lehtëson implementimin e suksesshëm të tyre. Studimet kanë argumentuar se vendet që kanë hapur/rritur transparencën e buxheteve të tyre, kanë një nivel korrupsioni më të vogël dhe njëkohësisht një implementim më të mirë të politikave ekonomike e sociale dhe të efikasitetit të shpenzimeve dhe investimeve publike. Një moment i rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e strategjive, reformave, politikave dhe projekteve konkrete zë cilësia e kostimit të objektivave me indikatorë dhe tregues të matshëm. Cilësia e përzgjedhjes përfshin edhe efikasitetin e përdorimit të burimeve të financimit.

Në këtë kontest qytetarët janë të interesuar për cilësinë e qeverisjes së vendit të tyre, ata janë kontribuesit kryesorë të burimeve buxhetore të qeverisë vendore dhe qendrore dhe njëkohësisht ata përfitojnë apo çënohen nga cilësia e funksioneve dhe shërbimeve publike.

Qeverisja e mirë konsiderohet sot një nga prioritetet kryesore për të përmirësuar cilësisht jetën e qytetarëve, për të rritur cilësinë e arsimit, shëndetit, ambientit, infrastrukturës ekonomike e asaj fizike në veçanti.

Pse duhet që Qeveria të prodhojë një Buxhet Qytetari?

Paratë në duar të qeverisë janë paratë e njerëzve të saj, të cilat vijnë nëpërmjet formave të ndryshme në mënyrë indirekte apo direkte të lidhura me popullatën. Në rastin e taksave, tarifave apo formave të tjera që pushteti qendror apo vendor vendos mbi popullatën që përfaqëson kemi të bëjmë me forma direkte të mbledhjes së të ardhurave. Por paratë për qeverinë shpesh vijnë edhe si rezultat i burimeve natyrore që një vend ka, që në fakt janë pjesë e trashëgimisë kombëtare që i takon njerëzve, madje edhe kur të ardhurat vijnë nga kreditë, barra e shlyerjes bije përsëri mbi popullin. Në të gjitha këto raste kemi të bëjmë me forma indirekte të të ardhurave të shtetit të lidhura me popullatën që përfaqëson. Të gjitha këto forma të ardhurash të shtetit duhet tu kthehen qytetarëve në forma të të mirave publike, për tu siguruar atyre shërbime më cilësore, më shumë akses e përkthyer në një nivel të mirëqenies socio-ekonomike më të lartë.

Në këtë kuadër është mëse normale dhe e domosdoshme që gjithmonë e më shumë të rritet nevoja e publikut për të qënë i informuar mbi shfrytëzimin e burimeve monetare. Publiku duhet të informohet për çdo lek që ka kontribuar në vendin e tij, e për më tepër edhe mbi përdorimin sa më efikas të tyre.

Në fakt informimi është vetëm njëra anë e monedhës, pasi një buxhet duhet të dëgjojë zërin e atyre të cilët kontribuojnë në të. Detyra e qeverisë nuk është vetëm të publikojë të dhënat mbi të ardhurat dhe shpenzimet që ajo bën, që në fakt është minimumi i detyrimit që ajo ka ndaj qytetarëve të saj. Detyra e një qeverie, si në aspektin qendror edhe atë vendor është që të dëgjojë dhe të përfshijë sa më shumë grupe qytetarësh që të përdori paratë e tyre në një mënyrë sa më eficiente për tu shërbyer.

Shpesh qeveritë e njohin dhe e mbështesin të drejtën themelore të qytetarëve për informim duke publikuar pasqyrat dhe planet buxhetore vjetore. Planet Buxhetore shpesh janë tepër komplekse në shumë aspekte; këto dokumente janë shkruar për përdorim të brendshëm, duke përdorur terma teknike të pakuptueshme nga publiku i gjerë. Nëse ata nuk mund të kuptojnë se çfarë u është paraqitur, ata nuk mund të bëjnë pyetje në lidhje me të. Njerëzit janë, në fakt, të paafte për të kërkuar llogaridhënie nga pushtetarët, të paafte për të sugjeruar se kush është më e mirë për ta e si rrjedhim të paafte për të qënë pjesë integrale e këtij sistemi.

Në këtë aspekt format e të ardhurave dhe shpenzimeve nuk duhet të paraqiten vetëm me tabela numerike, por duhet të marrin trajta të thjeshta dhe të kuptueshme nga të gjitha shtresat e njerëzve, në mënyrë që ata të kuptojnë pozicionin dhe rolin e tyre në këtë strukturë. Pikërisht këtë problematikë adreson Buxheti i Qytetarit, pasqyrimin në formë të thjeshtëzuar të buxhetit të një vendi.

Kush përfiton nga Buxheti i Qytetarit?

Sigurisht që përfituesit kryesorë janë direkt qytetarët, duke qënë se Buxheti i Qytetarëve synon të rrisë kapacitetin e qytetarëve për të marrë pjesë në procese qeverisëse. Megjithatë edhe vetë Qeveritë përfitojnë nga Buxheti i Qytetarëve. Gatishmëria e qeverisë për të përfshirë sa më shumë qytetarët dhe për ti bërë pjesë në procese sa më transparente çon në rritjen e imazhit dhe legjitimitetit të Qeverisë në opinionin publik.

Buxheti i Qytetarit nuk shërben vetëm si një mjet llogaridhënie por gjithashtu ai luan edhe një rol edukativ. Ai mund të jetë një mjet për të shpjeguar se si Buxheti është formuluar, miratuar dhe zbatuar, dhe cili institucion është përgjegjës në çdo fazë. Përmes Buxhetit të Qytetarit një qeveri mund të qartësojë se cili nivel (Kombëtar, Shtetëror apo Vendor) është përgjegjës për kryerjen e funksioneve të ndryshme qeveritare dhe ofrimin e shërbimeve. Ky informacion mund të lehtësojë punën e qeverisë duke minimizuar pyetjet ose kërkesat për informacion.

1. Buxheti dhe etapat e implementimit

1.1. Hyrje

Çdo vend, ashtu si dhe çdo njësi tjetër institucionale, mbështetet mbi një plan buxhet për të planifikuar të ardhurat që do mund të mbledhë dhe se si do të shpenzojë këto të ardhura për tu siguruar qytetarëve të vet, kushte më të mira jetese, shërbime më të mira dhe një mirqënie më të lartë. Në këtë kuadër buxheti mund të përkufizohet si një plan financiar, i cili përshkruan burimet kryesore të të ardhurave dhe se si këto para do të përdoren. Në nivel kombëtar, buxheti është një dokument gjithëpërfshirës që tregon në mënyrë të detajuar sesi qeveria do të mbledhë të ardhurat dhe si synon të përdorë këto të ardhura në mënyrën më produktive për të plotësuar nevoja të ndryshme të qytetarëve të saj. Në koncepte të ngjashme me buxhetin qendror ndërtohet edhe buxheti vendor, i cili ka në fokus një grup më të vogël njerëzish dhe në të njëjtën kohë një marrëdhënie më të drejtpërdrejtë me ta. Në mënyrë që një buxhet të jetë sa më efektiv dhe transparent ai është i nevojshëm të ngrihet mbi ligje, procedura ose rregullore, të cilat kanë si qëllim të mundësojnë kontrollin dhe monitorimin e tij.

Ky manual është prodhuar pikërisht për tu ardhur në ndihmë grupeve të interesit për të kuptuar sa më mirë funksionimin e një buxheti, etapat në të cilat kalon si dhe mundësitë reale që u jep ligji këtyre grupeve për të ndikuar në vendimmarrjet buxhetore.

Manuali do të shërbejë si një guidë për trajnimin që do të zhvillohet me grupet e interesit në bashkinë e Lezhës. Trajnimi do të shërbejë si pikënisje për përgatitjen e grupeve qytetare të cilët parashikohen të jenë pjesa më aktive e projektit, një grup i diversifikuar për nga angazhimi aktiv social e i qëndrueshëm që do të udhë-rrëfejë pjesëmarrjen e vazhdueshme të qytetarëve në diskutimet buxhetore të qeverisjes vendore. Në këtë kuadër trajnimi ka si objektiv që:

- Të rrisë aftësimin e qytetarëve të Bashkisë Lezhë me konceptin e buxhetit vendor dhe mënyrat sesi politikëbërja buxhetore ndikon në jetën e tyre;
- T'u ofrojë njohuri të thelluara pjesëmarrësve mbi buxhetin dhe t'i ndërgjegjësojë për rëndësinë e tij dhe pjesëmarrjen e tyre në etapat e buxhetimit;
- Të pajisë pjesëmarrësit me aftësi të nevojshme për përfshirjen e tyre në të ardhmen në faza të ndryshme të buxhetimit.
- Të njohë grupet e interesit, të cilëve ky trajnim do t'ju adresohet me bazën ligjore në kuadër të detyrimeve dhe të drejtave që ka bashkia e Lezhës kundrejt qytetarëve të saj.

1.2. Buxheti Vendor

Hendeku ekzistues mes institucioneve të pushtetit vendor dhe qytetarëve në të gjitha njësitë administrative të vendit mbetet shqetësues e përbën një nga pengesat kryesore në arritjen e sinergjisë së nevojshme e deri të domosdoshme që konsiston në bashkëpunimin e ndërsjelltë mes pushtetit vendor dhe qytetarëve. Një mungesë e tillë komunikimi, shkëmbimi informacioni, eksperience e ekspertize ka pasoja negative shumëdimensionale në cilësinë e qeverisjes në nivel vendor, efikasitetin në ofrimin e shërbimeve dhe tejçimin e zërit qytetar në instancat vendimarrëse të institucioneve vendore. Në këtë kuadër njohja e mirë e buxhetit vendor nga grupet e interesit është pikënisja e një shoqërie aktive në vendimmarrjet në nivel vendor.

Buxheti vendor është programi kryesor financiar vjetor i organit të pushtetit vendor. Buxheti vendor është unik dhe përbëhet nga pjesa e buxhetit të pavarur dhe pjesa e buxhetit të shtetit. Pjesa e buxhetit vendor të pavarur përbëhet nga të ardhurat dhe shpenzimet që, në përputhje me dispozitat ligjore, përfshihen në buxhetin e organeve të pushtetit vendor. Këshillat e organeve të pushtetit vendor janë organet e vetme që, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, kanë kompetencë të vendosin për hartimin, miratimin dhe zbatimin e kësaj pjese të buxhetit. Në tabelën 1 jepet një trajtë përmbledhëse e buxhetit vendor ku të ardhurat mund të vijnë nga tre burime kryesore ndërsa shpenzimet organizohen sipas programeve të ndryshme që ka bashkia.

Tabela 1: Të ardhurat - finacimet

Nr	Të ardhurat	Nr	PROGRAMI
I	Të ardhurat e veta	1	Planifikim-Menaxhim-Administrim
1	të ardhurat tatimore	2	Shërbimi i Gjendjes Civile
2	të ardhurat jotatimore	3	Mbështetje për Zhvillim Ekon. (Q.K.B-ja)
-	të ardhurat nga tarifat	4	Menaxhimi Infrastruk. Kullimit & Ujitjes
-	të ardhurat e tjera	5	Administrimi i Pyjeve
3	donacione	6	Transp.Rrugor/Mirëmbajtje Rr.Rurale
		7	Zhvillimi i Turizmit
II	Transfertat	8	Fond Rezervë & Fond Kontigjence
1	transf. e pakushtëzuar	9	Planifikimi Urban dhe Strehimi
2	transfertë specifike	10	Shërbime Publike Vendore
3	transf. e kushtëzuar	11	Ujësjetës-Kanalizime Vendore
		12	Zhvillimi i Sportit
III	Të trashëguara	13	Arti dhe Kultura
1	transf. e pakushtëzuar	14	Programe Kulturore dhe të Turizmit
2	të ardhura	15	Arsimi Parashkollor dhe 9 - Vjeçar
3	donacione	16	Arsimi Parauniversitar (Arsimi Mesëm)
		17	Arsimi Parauniversitar (Konvikti Sh.M)
		18	Shërbimi i Kujdesit Social
		19	Përkujdesi Social
		20	Shërbimi i borxhit (Kredia + Interesi)
		21	Emërgjencat Civile & PMNZSH

Burimi: Buxheti 2016, Bashkia Lezhë

Secili nga komponentët e kësaj tablele detajohet në një nivel shumë më të lartë për të kuptuar në mënyrë të plotë situatën në nivel vendor. Në rastin e bashkisë së Lezhës ka 21 programe për vitin 2016 të cilat specifikojnë edhe prioritetet që ka bashkia në vetvete.

Në listën e programeve kemi edhe programe specifike të cilat kanë një qëllim përdorimi më specifik siç është rasti i fondit të rezervës dhe fondit të kontingjencës.

- **Fondi rezervë** përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen ose janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Përdorimi i tij bëhet me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.
- **Fondi i kontingjencës** mund të krijohet për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave.

Buxheti vendor, si edhe çdo buxhet tjetër është i balancuar, përveç rasteve kur merret hua për financimin e shpenzimeve kapitale, që shërbejnë për një funksion specifik të njësisë së qeverisjes vendore.

1.3. Institucionet për përgatitjen dhe hartimin e buxhetit

Hartimi i buxhetit kalon në një sërë fazash zhvillimi derisa merr trajtën e plotë të tij. Në skemën e paraqitur në figurën 1 janë pasqyruar aktorët që marrin pjesë në procesin e një buxheti edhe në trajtën hierarkike të tyre. Buxheti i bashkive kalon në të njëjtat hallka si edhe Institucionet e pavarura dhe Ministrinë e linjës, ato dërgojnë buxhetin e tyre në Ministrinë e Financave për miratim e cila më pas i kalon në Këshillin e Ministrave dhe më tej për aprovim në kuvend.

Pra institucioni në krye të procesit të hartimit të buxhetit është Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.


Roli i **Kuvendit** është miratimi i të ardhurave dhe fondeve buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes qendrore, transfertat e pakushtëzuara për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve të tyre, si dhe burimet e financimit të deficitit buxhetor.

Këshilli i Ministrave miraton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe, në bazë të tyre, i propozon Kuvendit ligjin e buxhetit vjetor.

Ministri i Financave është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe miratimin e një sistemi rregullash, standardesh dhe procedurash, që sigurojnë administrimin ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve financiare publike.

Në bazë të udhëzimeve të nxjerrja nga Ministria e Financave, **bashkitë** përgatisin buxhetet e tyre respektive dhe ja paraqesin ato Ministrisë së Financave.

Figura 1: Hierarkia e institucioneve të përshfira në procesin e buxhetimit



Brenda bashkisë janë disa organe të cilat në bazë të kompetencave të tyre përfshihen në procesin hartimit të buxhetit vendor këto organe janë si më poshtë:

- **Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore**- Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.
- **Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore**- Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore propozon drejtimit kryesore të politikës së njësisë së qeverisjes vendore dhe projektbuxhetin në këshillin përkatës të njësisë së qeverisjes vendore. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore gjithashtu luan edhe rolin e **nëpunësit të autorizuar**. Ai/Ajo raporton përpara Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Këshillit përkatës vendor, për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar publik, monitorimin, raportimin dhe kontabilitetin e buxhetit të njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.4. Baza ligjore e procesit buxhetor

Kuadri ligjor që rregullon procesin e hartimit të buxhetit përshkruan qartë se si duhet të organizohet procesi i buxhetimit duke përfshirë zbatimin e buxheteve dhe monitorimin e zbatimit të buxhetit.

Kushtetuta - Kushtetuta përmban nene të caktuara për rregullimin e procesit buxhetor. Ligjet dhe rregulloret për rregullimin e procesit të buxhetimit duhet të jenë në përputhje me dispozitat e kushtetutës.

Ligji për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor - Ky ligj rregullon sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi. Ky ligj zbatohet nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme në të gjitha fazat e procesit buxhetor.

Ligji për buxhetin vjetor - Buxheti i Shtetit miratohet nga Kuvendi në ligjin e buxhetit vjetor. Duhet bërë dallimi midis ligjit të buxhetit vjetor, i cili vendos për shumat e të ardhurave dhe shpenzimeve, apo linjat e buxhetit të një viti dhe ligjit organik të buxhetit që përcakton tërësinë e parimeve, rregullave dhe procedurave të procesit buxhetor.

Vendime nga Këshilli i Ministrave - Këshilli i Ministrave miraton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe, në bazë të tyre, i propozon Kuvendit ligjin e buxhetit vjetor.

Udhëzime e Urdhra nga Ministri/ Ministria e Financave - Ministri i Financave është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe miratimin e një sistemi rregullash, standardesh dhe procedurash, që sigurojnë administrimin ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve financiare publike.

Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore- Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe të organeve përkatëse.

1.5. Parimet e buxhetimit

Parimet e buxhetimit i referohen rregullave teknike tradicionale të nevojshme për një menaxhim të mirë të financave publike. Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor janë:

- Gjithëpërfshirja - Buxheti duhet të përfshijë të gjitha operacionet fiskale, si nga krahu i të ardhurave ashtu edhe nga ai i shpenzimeve.
- Parashikueshmëria - Buxheti duhet të jetë i parashikueshëm në periudhë afatmesme në mënyrë që tu mundësojë aktorëve ekonomik planifikim sa më të saktë të prodhimit apo shërbimeve që ata ofrojnë për qytetarët.

- Kontestimi - Aktorët ekonomikë mund të kundërshtojnë apo të japin sugjerime për zëra të veçantë të buxhetit.
- Transparenca - Buxheti duhet të jetë i hapur për të gjithë dhe informacioni duhet të jetë në dispozicion në kohën e duhur.
- Thjeshtësia - Informacioni që jepet nga buxheti duhet të kuptohet lehtë nga palët e interesuara.
- Periodiciteti - Buxheti duhet të mbulojë një periudhë të caktuar kohore.
- Disiplina fiskale, në përputhje me stabilitetin makroekonomik dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social;
- Shpërndarja e burimeve, në përputhje me objektivat strategjike të Këshillit të Ministrave;
- Përdorimi ekonomik, eficient dhe efektiv i burimeve publike;
- Përgjegjësi të qarta për menaxhimin operacional;
- Respektimi me rreptësi i tërësisë së procesit;
- Përfaqësim – Buxheti duhet të përfaqësojë të gjitha grupet e interesit si dhe të ketë një trajtim të barazisë gjinore.

1.6. Funkcionet e buxhetit

Buxheti hartohet në mënyrë që ti mundësojë qeverisë të financoj operacionet e saj, të cilat ndikojnë në jetën e qytetarëve dhe nivelin e aktivitetit ekonomik në vend. Disa nga funksionet kryesore të buxhetit janë:

Funksioni i Alokimit - Qeveria luan rolin më të rëndësishëm në realizimin e objektivave të zhvillimit të një kombi. Nëpërmjet buxhetit qeveria ndikon ose drejton, nëpërmjet zbatimit të politikave dhe alokimeve financiare, zhvillimin e vendit. Në buxhet, fondet ndahen dhe përdoren për të financuar projekte për të nxitur zhvillimin.

Funksioni i Shpërndarjes - Ky funksion lidhet me faktin se procesi i ngritjes së fondeve publike ose burimeve dhe shpërndarja e tyre ndikon në sektorë të ndryshëm dhe tek qytetarët. Taksat dhe shpenzimet shpërndajnë barrën dhe përfitimet e mallrave në të gjithë ekonominë. Kështu funksioni i shpërndarjes arrihet përmes vendosjes së ngarkesave tatimore dhe ndarjen e përfitimeve të shpenzimeve publike. Në qoftë se shpërndarja e ngarkesave tatimore është për ata që janë në gjendje të paguajnë, dhe përfitimet e shpenzimeve shkojnë për ata që kanë më shumë nevojë, atëherë shpërndarja konsiderohet të jenë të drejta dhe të paanshme.

Funksioni i Stabilitetit - Funksioni i stabilitetit lidhet me objektivat makroekonomikë që janë të nevojshme për arritjen e një normë të pranueshme dhe të qëndrueshëm të rritjes ekonomike, çmime të qëndrueshme, duke përfshirë normat e interesit dhe bilancin e pagesave. Qeveria e përdor buxhetin për të arritur dhe për të ruajtur një nivel të dëshiruar të performancës në ekonomi, duke siguruar që taksat dhe shpenzimet janë të qëndrueshme në afatgjatë. Megjithatë, tatimi i tepruar dhe huamarrja mund të jenë burime kryesore të paqëndrueshmërisë ekonomike, të cilat mund të dëmtojnë përpjekjet për të rishpërndarë të ardhurat. Mbajtja e nivelit të qëndrueshëm të borxhit së bashku me përdorimin efikas të burimeve të borxhit promovon stabilitet ekonomik.

1.7. Fazat kryesore të procesit buxhetor

Viti buxhetor, për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, fillon nga data 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

Në mënyrë të skicuar fazate e buxhetimit janë pasqyruar në figurën 2.

Figura 2: Fazat e buxhetimit



Në nivel më të detajuar fazat e procesit buxhetor janë si më poshtë:

Faza 1: Planifikimi

Gjatë kësaj faze ndërmerren një sërë veprimesh për përgatitjen e buxhetit deri në miratimin e tij nga Kuvendi. Kjo fazë fillon me përgatitjen dhe propozimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike nga Ministra e Financave. Gjithashtu ndër veprimet e tjera që ndërmerren gjatë kësaj faze janë:

- Vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike e buxhetore;
- Përgatitja e udhëzimeve për përgatitjen e buxhetit;
- Projekti i programit buxhetor afatmesëm;
- Projekt buxheti vjetor;

Faza 2: Miratimi

Këshilli i Ministrave dërgon projekt buxhetin vjetor për miratim në Kuvend. Buxheti diskutohet bëhen rregullimet e nevojshme dhe miratohet. Kjo gjithashtu është faza në të cilën përgatiten dhe

miratohen buxhetet vendore. Projekt-buxheti vendor hartohet nga çdo bashki dhe miratohet nga këshilli përkatës.

Projekt buxheti për organet e pushtetit vendor paraqitet në prefekturë dhe në degën e buxhetit të rrethit, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë së Financave. Prefektura, pasi i shqyrton nga pikëpamja procedurale e teknike projektbuxhetet e organeve të pushtetit vendor të juridiksionit të saj, ja dërgon Ministrisë së Pushtetit Vendor, e cila ja paraqet pastaj Ministrisë së Financave. Nëse deri në fund të vitit buxhetor këshilli përkatës nuk miraton buxhetin vendor të pavarur, me fillimin e vitit të ri buxhetor vazhdojnë të përdoren për çdo muaj të ardhurat dhe shpenzimet në masën sa 1/12 e treguesve të miratuar në vitin e mëparshëm buxhetor. Ministria e Financave, në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Vendor, përgatit udhëzimet dhe aktet e tjera nënligjore, të nevojshme për hartimin e projektbuxhetit vendor, dhe udhëheq procesin e hartimit të këtij buxheti.

Pas miratimit të buxhetit ato botohen në fletoren zyrtare.

Faza 3: Zbatimi

Për të mbështetur fazën e implementimit të buxhetit Ministri i Financave nxjerr udhëzime për zbatimin e buxhetit, ku përcaktohen rregullat, procedurat dhe afatet që duhet të përmbushin nëpunësit, autorizues dhe zbatues, të të gjitha niveleve, në procesin e zbatimit të buxhetit.

Në muajin qershor të çdo viti, por jo më vonë se dita e paraqitjes së programit buxhetor afatmesëm në Këshillin e Ministrave, Ministri i Financave paraqet përpara Këshillit të Ministrave një analizë për zbatimin e buxhetit të vitit në vazhdim.

Faza 4: Kontrolli

Në fazën e fundit parlamenti kontrollon zbatimin e ligjit të buxhetit vjetor, si gjatë periudhës së ushtrimit të tij, ashtu dhe pas mbylljes së saj. Kontrolli ushtrohet kryesisht nëpërmjet raportimeve që qeveria detyrohet të paraqesë në parlament sipas kërkesave të bëra prej tij. Gjithashtu një moment i rëndësishëm i kësaj faze është verifikimi i llogarive financiare nëpërmjet një organi të pavarur të kontrollit të jashtëm, detyrë kjo që në Shqipëri ushtrohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

1.8. Kalendari i buxhetimit

Për të mbështetur procesin e përgatitjes së buxhetit, krijohet një kalendar aktivitetesh ku paraqiten veprimet dhe afatet kohore e aktiviteteve kryesore që ndërmerren që nga përgatitja deri në miratimin e tij. Në tabelën e mëposhtme drejtkëndëshat tregojnë procese me fillim dhe mbarim të para-caktuar. Shpesh kalendari është i shoqëruar edhe me trekëndësha të cilët tregojnë datat e paracaktuara për zhvillimin e një aktiviteti.

Tabela 2: Fazat Kryesore të buxhetimit

Fazat kryesore/Muajt	J	Sh	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH
Përgatitja e kuadrit makroekonomik												
MF cakton tavanet sipas sektorëve												
Kabineti miraton Strategjinë dhe tavanet												
Udhëzimi plotësues për përgatitjen e buxhetit							Brenda datës 10 Korrik					
Ministritë e linjës paraqesin kërkesat për buxhet												
MF shqyrton kërkesat për buxhet/negocime												
MF përgatit projekt-buxhetin												
Këshilli i Ministrave shqyrton projekt-buxhetin										Brenda datës 15 tetor		
Buxheti i kalon parlamentit										Brenda datës 20 Tetor		
Parlamenti shqyrton dhe miraton buxhetin.												Brenda datës 15 Dhjetor

2. Buxheti i Qytetarit

2.1. Çfarë është Buxheti i Qytetarit?

Buxheti i Qytetarit është një kuadër informues e raportim tek qytetarët për t'i pajisur ata me mjetet e nevojshme për të kuptuar dhe për të përmbushur detyrimin e tyre si qytetarë aktivë për të qënë pjesë integrale në proceset vendimmarrëse me impakt të madh në jetën e tyre të përditshme. Një Buxhet Qytetari është ai buxhet i cili përmbush cilësitë e mëposhtme:

1. Është prodhuar nga qeveria;
2. Është prodhuar në konsultim me qytetarët;
3. Mundëson të kuptuarit publik dhe pronësinë e buxhetit;
4. Shërben si një "derë" për më shumë informacion në lidhje me buxhetin;
5. Fokuset në dokumentet e planifikimit të buxhetit;
6. Publikohet rreth të njëjtën kohë si buxheti;
7. Është i shpërndarë gjerësisht, mundësisht në formate të shumta.

Që një buxhet qytetari të jetë sa më funksional dhe të plotësojë në mënyrë sa më të mirë objektivat e tij është parakusht zhvillimi i konsultimeve dhe përfshirja e të gjitha grupeve të interesit në këtë proces.

2.2. Rëndësia e Konsultimeve

Hapi i parë në hartimin e një Buxhetit për Qytetarët sigurisht që duhet të jetë konsultimi me njerëzit për të gjetur se çfarë ata do të dëshironin të shihnin në të. Çfarë duhet të përfshihet përmbajtjen? Si mund të arrijnë qeveria ata? Cilat janë idetë e njerëzve për mënyrën se si një buxhet të Qytetarëve duhet të shpërndahet? Në çfarë media dhe formate duhet të paraqitet informacioni? Kjo siguron që Buxheti i Qytetarit do të lexohet dhe përdoret nga targeti i synuar, pra qytetarët.

Transparenca e proceseve vendimmarrëse është një nga komponentët kryesorë të një procesi demokratik politikbërës. Njësia vendore duhet të jetë e para e interesuar jo vetëm për ti ofruar qytetarëve procese sa më transparente, por edhe ti përfshijë ato në çdo fazë.

Në përputhje me **nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit"**, autoritetet publike e kanë për detyrim të përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe të vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.

Përtej detyrimeve ligjore për llogaridhënie, autoritetet vendore duhet të rrisin gadishmërinë e tyre për transparencë për arsyet e mëposhtme:

- Vendimet buxhetore kanë një ndikim të rëndësishëm në jetën e publikut, dhe për këtë arsye në të duhet të përfshihen pikëpamjet dhe vlerat e qytetarëve;
- Angazhimi i qytetarëve në procesin e buxhetimit rrit informacionin në dispozicion të vendimmarrësve në lidhje me efektet e mundshme të vendimeve të tyre në komunitetet, dhe mund të ndihmojë për tu mbrojtur kundër pasojave të paqëllimshme;
- Shqyrtimi i qytetarëve mund të ndihmojë për të siguruar që vendimmarrësit janë të zellshëm në vendimet që ata marrin, përmirësimin e efikasitetit, rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së qeverisë dhe ruajtjen kundër korrupsionit;
- Nëpërmjet angazhimit të qytetarëve në procesin e buxhetit, ata mund të trajtojnë të njëjtat kompromise që vendimmarrësit janë të detyruar të bëjnë, dhe të gjenerojë një diskutim më të frytshëm mes qytetarëve dhe qeverisë;

- Angazhimi në vendimet themelore, të tilla si vendimet buxhetore, mund të ndihmojë për të kapërcyer mosbesimin publik dhe cinizmin, dhe për të rritur legjitimitetin e qeverisë;
- Angazhimi qytetar mund të ndihmojë për të siguruar se qeveria është e përgjegjshme për nevojat, pikëpamjet dhe vlerat e qytetarëve.

2.3. Lobimi i grupeve të interesit

Lobimi është një formë e përfaqësimit të interesave publikë. Nëpërmjet lobimit grupet e interesave përpiqen, mbi të gjitha në pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ, të ndikojnë në politikë. Kompani të mëdha, OJQ (organizata jo qeveritare), dhe shumë lloje të ndryshme grupesh, përpiqen të përcjellin interesat e tyre në politikë. Në ditët e sotme grupet e interesave mund të jenë dhe persona privatë, të cilët përfaqësojnë zyra avokatie, Think Tanks, gazetarë etj, të cilët kanë ndikim të madh në fusha të ndryshme. Qytetarët kanë shumë stimuj për të marrë pjesë në programet e buxhetimit. Së pari, pjesëmarrësit gëzojnë rritje qasje në objektet e vendimmarrjes publike. Takimet publike dhe proceset vendimmarrëse zvogëlojnë gjasat për përdorimin e manovrave klienteliste për shpërndarjen e prioritetëve. Natyra publike e takimeve ka potencial për të inkurajuar aktorët jo-tradicionale të flasin. Fuqizimi forcohet edhe më tej në qoftë se qytetarët arrijnë të përfitojnë nga lidhja e drejtpërdrejtë midis përpjekjeve të tyre të pjesëmarrjes dhe rezultatet e politikave.

Aksesi në informacion i ofron qytetarëve një kuptim më të gjerë të qeverisë, përgjegjësisë të tyre dhe hartimi të politikave. Përveç informacionit të buxhetit, qytetarët kanë gjithashtu akses edhe në informacionin teknik si legjislacioni ose paketa fiskale. Rregullat komplekse të përfshira në këto çështje janë shpesh përtej arritjes së qytetarit mesatar.

Një përfitim i përfshirjes së qytetarëve në procese buxhetore është shpërndarja e prioritetëve dhe cilësia e shërbimeve të ofruara. Qytetarët advokojnë për ato shërbime të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre të përditshme.

2.3.1. Rinia

Buxheti i Qytetarëve duhet të ketë një fokus të veçantë në përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të rinjve gjatë procesit të hartimit, si një grup interesi i prekur drejtpërdrejtë nga vendimet mbi ndarjen e këtij të fundit. Ndarja e buxhetit ndikon në aspekte kyçe të jetës së të rinjve si arsimit, punësimi, aktivitetet sportive etj. Prioritetet kryesore të këtij grupimi mund të diskutohen përmes takimeve të hapura të qeverisë me përfaqësues të grupimeve rinore, OJQ-ve, apo institucioneve me fokus mbi çështjet e rinisë. Elemente të rëndësishëm si cilësia e arsimit, tarifatat e universiteteve publike, mundësitë e punësimit, mbështetja dhe nxitja e sipërmarrjeve inovative përmes lehtësimit të barrës fiskale, krijimi i ambienteve të përshtatshme sportive, alternativat për

aktivitete të ndryshme jashtë kurrikulare etj. Mund të vihen në fokus të këtyre diskutimeve dhe të përkthehen në hapa konkrete gjatë hartimit final të buxhetit.

2.3.2. Shoqëria Civile

Buxheti i Qytetarëve siguron një mekanizëm për përfshirjen sa më të madhe edhe të shoqërisë civile. Shoqëria civile, e përfaqësuar në shumë raste edhe nga OJQ-të, ka si synim të trajtojë problemet më të ngutshme sociale dhe të luajë një rol të drejtpërdrejtë në programin e buxhetimit. Ajo mund veprojë si ndërmjetës midis qeverisë dhe pjesëmarrësve për të përfaqësuar sa më mirë interesat e grupeve të ndryshme. Kur OJQ-të kanë një rol të drejtpërdrejtë në këtë proces, ato kanë tendencë për të nxitur fuqizimin e qytetarëve dhe transparencën në qeverisje. Në komunat e tjera, OJQ-të kanë në një rol këshillues, duke siguruar mbështetje për pjesëmarrësit. Shumica e OJQ-ve kanë aftësi të forta teknike dhe administrative, më shumë se shumica e pjesëmarrësve mesatare, për shkak të profesionalizimit të tyre.

OJQ-të shpesh janë më të kualifikuar se qeveritë për të shpërndarë informacione komplekse qytetarëve. Shumë OJQ janë kontraktuar shpesh për të ofruar këtë shërbim.

2.3.3. Media

Funksionet e medias në procesin e hartimit të Buxhetit janë kryesisht informuese dhe nxitëse. Përsa i përket funksionit informues, media, përmes frekuencës apo mënyrës së pasqyrimin të ngjarjeve dhe shqetësimeve kryesore në vend, mund të përcjellë dhe nënvijëzojë problemet dhe prioritetet kryesore për qytetaret e vendit, duke informuar organet hartuese të buxhetit mbi to. Në këtë mënyrë media luan një rol ndërmjetësues mes qeverisë dhe qytetarëve dhe përshpejton procesin e komunikimit mes këtyre dy grupimeve, duke ndikuar rrjedhimisht në mënyrën e ndarjes së këtij buxheti.

Përsa i përket funksionit nxitës, në rastet kur qytetarë apo grupe të ndryshme interesi ngrenë shqetësime të caktuara mbi elementë të buxhetit, përmes medias këto grupime mund të rrisin ndërgjegjësimin qytetar dhe të nxisin një pjesëmarrje dhe reagim më të konsiderueshëm. Në këtë formë këto grupime mund të sjellin këto çështje në vëmendjen e qeverisë dhe mund të ndikojnë në hartimin e buxhetit dhe kanalizimin e tij në sektorë të caktuar si arsimit, shëndetësia, transporti etj.

2.3.4. Komuniteti i Bizneseve

Komunitetet e Bizneseve mund të mbështesin programet e buxhetit të qytetarëve duke qënë se këto programe promovojnë transparencën dhe ulin korrupsionin. Bizneset përfitojnë nga pjesëmarrja e tyre duke qënë se ndikojnë në programet e paketave fiskale.

Gjithashtu kur buxheti i qytetarit është i konsoliduar, shoqatat e biznesit kuptojnë se ata duhet të marrin pjesë për të siguruar përmirësime. Një shoqatë biznesi mund të dëshirojë, për shembull, të ketë rrugë të shtruara apo ndriçim vënë në rrugën ku një numër i madh biznesesh operojnë. Shoqata e biznesit do të duhet të organizojnë anëtarët e saj për të marrë pjesë në takime për të siguruar se kërkesat e tyre janë plotësuar.

2.4. Perspektiva gjinore në shpërndarjen e burimeve

Buxhetet e qeverisë dhe ato vendor duket të jenë neutrale, ato zakonisht nuk bëjnë referenca për burrat dhe gratë, pa specifikuar se kush po përfiton. Megjithatë, se si buxhetet janë shpenzuar varet nga prioritetet dhe zgjedhjet e bëra, të cilat më pas kanë ndikim në jetën e burrave dhe grave. Burrat dhe gratë shpesh kanë nevoja dhe prioritete të ndryshme, përballen me kufizime të ndryshme dhe kanë aspirata të ndryshme që kontribuojnë në zhvillim në mënyra të ndryshme. Është me rëndësi të njohim, respektojmë dhe punojmë me të dy perceptimet, femërore dhe mashkullore.

Gratë shpesh kanë ngarkesë të punës së ashtuquajtur e trefishtë, angazhuar në punë produktive, riproduktive dhe të komunitetit, përderisa kjo punë nuk është e njohur shpesh si punë e vërtet në statistika dhe nuk shihet që ka vlerë, madje edhe nga vetë gratë.

Ndarja gjinore e punës shpesh i vë gratë në një pozitë të pafavorshme. Ku roli i gruas është përcaktuar nga shoqëria të jetë në ekonominë familjare, ajo mund të përballlet me vështirësi në pjesëmarrje në vendim-marrje në fshatrat ose qytetet e tyre, edhe në qoftë se vendime të tilla ndikojnë drejtpërsëdrejti në jetën e tyre.

Në sferën ekonomike, gratë shpesh kanë qasje të kufizuara në punësim të paguar dhe kur paguhet, mund të marrin paga më të ulëta se burrat-madje edhe kur kryen detyra të njëjta. Ato gjithashtu ballafaqohen me vështirësi në përdorimin e burimeve të tilla si toka, kreditë, informim, edukim, trajnim dhe pasuri/pronë. Gratë zakonisht janë të varura nga burrat që të sigurojnë këto burime, një situatë e tillë konsiderohet normale në shumë shoqëri. Si pasojë, femrat shpesh nuk zotërojnë tokën në të cilën ato punojnë apo shtëpi në të cilën ato jetojnë. Mungesa e aktiviteteve të grave do të thotë se ajo mund të ketë vështirësi për marrjen e kredive për investime.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) është dokumenti kryesor i planifikimit për politikën ekonomike të qeverisë. Në muajin korrik 2012, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë miratoi Vendimin nr.465 (VKM), datë 18.7.2012 “Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm”.

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ) është strategji për integrimin e perspektivës gjinore në planifikimin ekonomik dhe në buxhetin qeveritar. Me të synohet që të përvetësohet një

perspektive për përmirësimin e barazisë së grave dhe burrave në bazë të një analize gjinore në secilën fazë të planifikimit, programimit, dhe realizimit të buxheteve qeveritare.

Është e qartë se vullneti politik për të trajtuar ndikimin e politikave publike mbi çështjet gjinore ishte kyçe në ndryshimin e buxheteve për të reflektuar më mirë nevojat e ndryshme të burrave dhe grave. Kemi mësuar se koalicionet dhe evokimi mund të çojnë në rezultate të mira.

Nga raste të shumta, duke përfshirë edhe rastet nga Zvicra, është e qartë se suksesi i BPGJ-së varet shumë nga të dhënat në dispozicion dhe përcakton se cili mjet në fakt mund të aplikohet. Për shembull, analizë më komplekse ekonomike ishte e mundur të bëhej në Zvicër, për të shqyrtuar se sa larg të dy palët, djemtë dhe vajzat, kanë përfituar nga buxheti komunal në sektorë të ndryshëm; megjithatë, edhe këtu ndonjëherë ishte e vështirë për të marrë të dhënat e kërkuara.

Siç e ka përmendur në fjalimin e saj rreth buxhetimit gjinor në vendet Nordike dhe atë të BE-së, Anne Havnor nga Ministria Norvegjeze për Fëmijë dhe Çështje Familjare tha se transparenca dhe pjesëmarrja janë të nevojshme për buxhetimin gjinor. Kjo është një çështje që gjithashtu është ngritur gjatë trajnimeve rreth buxhetimit gjinor në Kosovë. Havnor gjithashtu ka përmendur se bashkëpunimi në mes ministrive të financave dhe autoriteteve kombëtare përgjegjëse për barazi gjinore është i një rëndësie të veçantë.

2.5. Roli dhe Ndikimi i Medias

Qeveritë duhet të bëjnë përpjekje të konsiderueshme për të shpërndarë buxhetet e tyre qytetarëve. Shpërndarja efektive do të varet pjesërisht në zgjedhjen e drejtë të kanaleve shpërndarëse – Media, shtypi, internet, etj të cilat ka të ngjarë të jenë më efektive në arritjen e audiencës së synuar.

Është thelbësore të vlerësohet nëse disa grupe do të kenë vështirësi për të aksesuar informacionin e shpërndarë. Në një rast të tillë, qeveria duhet të marrë parasysh disa faktorë në zgjedhjen e kanalit që do të përdori për të përhapur të Buxhetin e Qytetarit. Kjo kërkon një bashkëpunim të ngushtë me Median e rajonit.

Media luan një rol kyç në informimin e qytetarëve, duke ofruar një platformë gjithëpërfshirëse dhe mundësinë e krijimit të dialogut publik dhe debatin. Media stimulon komunikimin ndërpersonal dhe në fund të fundit, krijimin e politikave që përfitojnë një numër më të madh të njerëzve.

Media mund të ketë një ndikim të konsiderueshëm në politikat publike, nëse ata mbledhin vëmendje të mjaftueshme publike. Ata mund të çojnë në ndryshime të politikave konkrete, por ata duhet të sigurojnë një dispozitë të qëndrueshme të raporteve të lajmeve dhe të ruajnë besueshmërinë e tyre.

Media mund të përmbushë pesë funksione kryesore në kontekstin e proceseve të transparencës dhe nxitjes së llogaridhënies:

Mobilizimi i publikut - Para së gjithash, media luan një rol qendror për publicitet. Një ngjarje që nuk është e mbuluar nga mediat, nuk tërheq vëmendjen e njerëzve. Kjo gjithashtu vlen për proceset buxhetore. Proceset pjesëmarrëse të buxhetimit që janë përmendur vetëm në një njoftim të vogël në faqen e fundit të një gazete vështirë se do të nxisin pjesëmarrjen dhe diskutimin publik. Kjo do të thotë, se gazetarët mund të ndihmojnë proceset pjesëmarrëse për të arritur shikueshmërinë e publikut. Pa advokim, proceset pjesëmarrëse janë të dënuar të dështojnë.

Formimi i opinionit publik -Jo vetëm shkalla e mbulimit mediatic është e rëndësishme por lloji i mbulimit gjithashtu luan një rol të rëndësishëm. Qytetarët vështirë se do të shqyrtojnë procesin e buxhetimit si të suksesshëm, në rast se ato janë komentuar në mënyrë shumë kritike ose negative nga mediat. Kështu, pak njerëz do të duan të angazhohen në një proces, i cili ngjall konotacione negative në diskutim publik.

Shqyrtimi kritik i procesit (vëzhguesit) - Edhe në qoftë se raportimi kritik mund të dëmtojë proceset pjesëmarrëse, është shumë e rëndësishme. Mediat kanë një funksion të rëndësishëm kontrolli. Ato vëzhgojnë politikën dhe administratën dhe, për shembull, denoncojnë mungesën e transparencës.

Është e rëndësishme pse jo edhe të jenë tepër kritikë, dhe mbi të gjitha, të bëhen krahasime kuptimplota. Vetëm gazetarët e kualifikuar mund të interpretojnë statistikat e pjesëmarrjes si duhet, dhe mund të prodhojnë një shqyrtimi kritik dhe të drejtë të procesit.

Transferimi i informacionit dhe "përkthimi" i njohurive - Një rol tjetër i rëndësishëm i gazetarëve është të përcjellë informacion të saktë mbi temën. Ndërsa personeli administrativ shpesh lufton për të dhënë një llogari të kuptueshme të njohurive të tyre komplekse, kjo është një nga kompetencat kryesore të gazetarëve. Nga përpunimi i informacionit të dhënë nga administrata e komunës, për shembull duke krijuar vizuale tërheqëse, gazetarët mund të mbështesin fuqimisht procesin e buxhetimit.

Llogaridhënia dhe feedbacku - Gazetarët luajnë një rol të rëndësishëm jo vetëm gjatë fazave të informacionit dhe pjesëmarrjes. Gjithashtu gjatë fazës së llogaridhënies, gazetarët janë në masë të madhe përgjegjës për informacion mbi vendimmarrjen duke arritur publikun. Ajo mund gjithashtu të jetë e dobishme në qoftë se gazetarët insistojnë në dhënien e informacionit mbi rezultatet e fazës së pjesëmarrjes.

Në praktikë megjithatë, kjo është harruar shpesh. Jo vetëm politikë-bërësit, por edhe mediat tentojnë të marrin në konsideratë se proceset e buxhetimit përfundojnë pas fazës së pjesëmarrjes

aktive. Një përshkrim i hollësishëm të asaj që ndodhi me rezultatet e pjesëmarrjes në proces nuk është dhënë shpesh.

2.5.1. Si mund bashkitë të mbështesin një angazhim aktiv dhe pozitiv të Medias?

Është e domosdoshme, që të angazhohen dhe të trajnohet media në fillim të procesit. Ata kanë nevojë për informacion, për shembull për proceset pjesëmarrëse në qytete të tjera, dhe mbi qëllimet, limitet dhe shanset e buxhetimit, në mënyrë që të formojnë mendimin e tyre, dhe të mos mbështeten në opinione individuale.

Përveç sigurimit të medias me informacion të mjaftueshëm, transparenca dhe sinqeriteti janë thelbësore. Bashkitë duhet të përfshijnë reagime kritike të mediave në mënyrë konstruktive - veçanërisht që mediat të pasqyrojnë tendencat dhe mendimet brenda shoqërisë.

Një buxhet qytetari ka për qëllim jo vetëm të paraqesi informacionet buxhetore të thjeshtëzuara por edhe ti përgjigjet disa nga pyetjeve më të kërkuara të qytetarëve.


3. Buxheti i Bashkisë Lezhë

3.1. Nga vijnë paratë e buxhetit?

Të ardhurat e buxhetit vendor përbëhen nga tre komponentë:

- a. Të ardhurat nga burimet brendshme lokale, në të cilat përfshihen të ardhurat tatimore dhe jotatimore, të ardhura nga veprimtaritë ekonomike në varësi të pushteti lokal etj.
- b. Të ardhurat nga buxheti i shtetit
- c. Të ardhurat nga ndihmat dhe kreditë

Grafiku 1: Përbërja e të ardhurave



Burimi: Buxheti 2016, Bashkia Lezhë

Pjesa më e madhe e të ardhurave të buxhetit të vitit 2016 përbëhet nga burimet e brendshme. Në tabelës e mëposhtme jepet një përmbledhje të të ardhurave të sipas burimeve dhe nënndarje të tyre ku vihet re që pjesa kryesore përbëhet nga të ardhurat tatimore e jotatimore me 55% të totalit të të ardhurave.

Tabela 3: Të ardhurat e Buxhetit të Lezhës sipas burimit

Burimi i të Ardhurave		Buxheti 000/lekë	Në %
Nga Burimet Qëndrore	Transferta e pa-kushtëzuar	230.553. ³	19. ²⁸
	Transferta e kushtëzuar	9.500. ⁴	0. ⁸⁰
	Transferta specifike	256.840. ⁶⁹	21. ⁴⁸
Nga Burimet e veta Vendore	Të ardhurat tatimore e jotatimore	660.450	55. ²⁴
	Të ardhurat dhe granti i trashëguar nga viti 2015	35.092. ⁴⁶	2. ⁹⁴
Të ardhurat nga donatorët	-----	3.123.1	0.26
Totali		1.195.559.⁹⁵	100%

Burimi: Buxheti 2016, Bashkia Lezhë

Gjithashtu nëse do të mbështeteshim në një analizë më të detajuar të këtyre komponentëve të zberthyer në nën-komponentë mund të përmendim se disa nga tregues më të rëndësishëm të të ardhurave janë:

- Të ardhurat nga taksat janë **510.110 mijë lekë** dhe zënë **76.⁸⁸ %** në totalin e të ardhurave nga burimet e veta;
- Të ardhurat nga tarifatat vendore janë **104.010 mijë lekë** dhe zënë **15.⁶⁷ %** në totalin e të ardhurave nga burimet e veta;
- Të ardhurat nga burimet e tjera janë **46.330 mijë lekë** dhe zënë **6.⁹⁸ %** në totalin e të ardhurave nga burimet e veta;
- Të ardhurat nga donatorët janë **3.123.¹ mijë lekë** dhe zënë **0.⁴⁷ %** në totalin e të ardhurave nga burimet e veta.

Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit:

- Formula e re e ndarjes së transfertës pakushtëzuar identifikon nevojat për shpenzime, duke u bazuar tek **popullsia relative**;
- Nga kjo formulë bashkia ka si burim përfitim **94 %** të grantit pakushtëzuar ose 217.273.⁵ mijë lekë (79500 banorë me 2.733 lekë për frymë);
- Mbi bazën e **numrit të nxënësve në shkollat publike** nëntëvjeçare e të mesme bashkia përfiton 13.279.⁸² mijë lekë (10391 nxënës x 1278 lekë/nx.) ose **6 %** e grantit të pakushtëzuar;

Transferta specifike dhe e kushtëzuar:

Tabela 4: Transferta sipas funksioneve (mijë lekë)

Konvikti i arsimit parauniversitar (arsimi i mesëm profesional)	12.729. ⁹
Shërbimi i mbrojtës nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH)	25.734. ⁷⁵
Shërbimi i Gjendjes Civile	7.868
Arsimi parashkollor, bazë dhe parauniversitar	130.669
Administrimi i Pyjeve	3.065. ⁹²
Ujitja dhe Kullimi	79.684. ¹²
Rrugët Rurale	4.957
Qendra Kombëtare e Biznesit	1.632. ⁴

Burimi: Buxheti 2016, Bashkia Lezhë

Të ardhurat nga taksat vendore:

- Pjesë e rëndësishme e taksave vendore është **taksa mbi pasurinë**, e cila është parashikuar të jetë **100.530 mijë lekë**, ku zënë **19.7 %** e të ardhurave gjithsej nga taksat;
- Në të ardhurat tatimore të parashikuara peshën më të madhe specifike e zënë të ardhurat nga **taksa e ndikimit të infrastrukturës** nga ndërtimet e reja që zënë rreth **60.8 %** e të ardhurave gjithsej nga taksat.

3.2. Ku do shkojnë paratë e qytetarëve?


Çdo qytetar ka dëshirë të dijë se ku do shkojnë paratë e tij, për tju përgjigjur kësaj pyetje mjafton të hedhim një sy shpërndarjes së shpenzimeve sipas programeve. Në bazë të dhënave të buxhetit të Lezhës rezulton se pjesa më e madhe e të ardhurave, 31 %, do shkojnë për shërbimet publike. Po një përqindje afërsisht e madhe do shkojë për administratën publike, ndërkohë që fusha të tjera siç mund të jenë arsimi zë 17 % të shpenzimeve.

Disa tregues të rëndësishëm të shpenzimeve janë:

- Parashikimi i shpenzimeve është **1.195.559.⁹⁵ mijë lekë**;
- **Fondi i pagave** gjithsej për vitin 2016 është **469.438.⁹¹ mijë lekë**;
- **Fondi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore** është **75.853.¹⁵ mijë lekë**;
- **Fondi rezervë dhe Fondi i kontingjences** janë parashikuar secili **5.000 mijë lekë**;
- **Kuota e Qarkut** është llogaritur në masën **20.405.⁷⁶ mijë lekë** për vitin 2016;
- **Investimet** për vitin 2016 janë parashikuar **205.401.¹ mijë lekë**, të cilat do të financohen nga granti 44.⁹ % ose 92.220 mijë lekë, nga të ardhurat 26.¹ % ose 53.558 mijë lekë, nga buxheti i shtetit 27.⁵ % ose 56.500 mijë lekë dhe nga donatorët 1.⁵ % ose 3.123.¹ mijë lekë;

- **Fondi për shpenzime operative** do të jetë **374.596.⁰³ mijë lekë**, ku fondi për shërbimin e pastrimit, largimin e mbeturinave, gjelbërimin, dekorin dhe shërbimin funeral janë parashikuar në vlerën 100.000 mijë lekë.

Grafiku 2: Planifikimi i Shpenzimeve sipas Programeve



Burimi: Buxheti 2016, Bashkia Lezhë dhe punime të autorit

3.3. Numri i punonjësve të bashkisë për vitin 2016

Bashkia Lezhë për vitin 2016 do të organizojë punën e saj në 9 njësi administrative, 11 drejtori, 6 institucione varëse dhe 6 agjensi. Për vitin 2016 bashkisë i janë transferuar edhe 6 funksione të reja, si sektori PMNZSH, personeli mësimor e jomësimor i arsimit parashkollor, personeli jomësimor i arsimit parauniversitar, rrugët rurale, administrimi i pyjeve, dhe ujitja e kullimi.

Tabela 5: Numri i përgjithshëm i punonjësve të bashkisë

Punonjës të administratës së bashkisë	142 vetë
Policë bashkiak	14 vetë
Punonjës të njësive administrative	148 vetë
Punonjës të institucioneve varëse	50 vetë
Punonjës të Agjensive	150 vetë
Punonjës me kontratë 6 mujore	25 vetë (vjetore)
Punonjës të funksioneve të deleguara	256 vetë
TOTALI	785 vetë

Burimi: Buxheti 2016, Bashkia Lezhë

Numri i punonjësve sipas njësive administrative do të jetë:

Tabela 6: Numri i përgjithshëm i punonjësve sipas njësive administrative

Nr	Njësiti administrative	Numri i Punonjësve
1	Shëngjin	30
2	Shënkoll	20
3	Balldre	18
4	Blinisht	13
5	Kallmet	13
6	Dajç	13
7	Zejmen	15
8	Kolsh	13
9	Ungrej	13

Burimi: Buxheti 2016, Bashkia Lezhë

4. Taksat Vendore dhe Platforma Financat vendore

4.1. Hyrje

Bashkia e Lezhës

Për këtë qëllim analizën e instruktuar në kete manual do ta mbështesim mbi raportin e kësaj Platforme e cila ka pasqyruar në mënyrë të detajuar të gjitha taksat dhe tarifatat e mbledhura nga bashkia e Lezhës.

4.2. Platforma Financat Vendore www.financatvendore.al

Ngritja e kësaj platforme vjen si propozim i Co-PLAN, Institutit për Zhvillimin e Habitatit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Shtetit për Çështjet Vendore, mbështetur nga fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, SOROS.

Kjo platformë mundëson jo vetëm ndarjen e të dhënave financiare dhe fiskale të njësive të qeverisjes vendore, por dhe interpretimin e tyre - është mundësia që u ofrohet të dy niveleve të qeverisjes për të marrë vendime të informuara, bazuar në një bazë sistematike të dhënash dhe treguesish krahasimorë.

Qëllimi i ngritjes së kësaj platforme është të sigurojë mbështetje për OSHC-të dhe aktorë të tjerë, të interesuar për të aksesuar, kuptuar, monitoruar dhe përdorur në mënyrë analitike të dhënat mbi performancën financiare në nivel vendor në Shqipëri. Të dhënat e besueshme mbi financat vendore janë kritike gjatë përgatitjes së parashikimeve fiskale apo gjatë menaxhimit financiar.

4.3. Taksat e Bashkisë Lezhë

Ky portal mundëson aksesin në paketat fiskale të bashkive të ndryshme. Kjo kategori përfshin të dhëna për gjithë të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore që mund të grumbullojë një njësi e qeverisjes vendore të ndara si më poshtë:

4.3.1. Taksa e biznesit të vogël

Taksa e biznesit të vogël deri në vitin 2013 mbliidhej nga autoriteti i qeverisjes vendore për të gjitha ato biznese të cilat operojnë në kufirin administrativ të njësisë vendore. Çdo entitet i cili, gjatë një viti fiskal, gjeneron xhiro vjetore më pak apo deri në **8 milion lekë**, është subjekt i tatimit të taksës së biznesit të vogël (pas vitit 2013, taksës mbi fitimin e biznesit).

Vlera e taksës: Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim nga **5 deri në 8 milionë lekë**, është **5 %** dhe për subjektet me qarkullim vjetor nga **0 deri në 5 milionë lekë**, është **0 lekë në vit**.

4.3.2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë të pasurive në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:

- ❖ **Taksa mbi ndërtesën;**
- ❖ **Taksa mbi tokën bujqësore.**
- ❖ **Taksa mbi truallin**

Taksa mbi tokën bujqësore— Taksa mbi tokën bujqësore është pjesë e taksës mbi pasurinë e paluajtshme. Çdo person fizik apo juridik, shtetas apo i huaj, i cili zotëron një pronë në territorin e Shqipërisë është subjekt i taksës mbi pasurinë e paluajtshme. Barra e kësaj takse bie mbi pronarin ose bashkëpronarin, në varësi të pjesës që secili zotëron. Baza e kësaj takse është sipërfaqja e tokës bujqësore në hektarë (ha). Sipërfaqja e tokës përcaktohet sipas dokumentacionit përkatës mbi pronësinë.

Vlera e taksës: Sipas kategorisë së tokës bujqësore vlera e taksës varion nga **1260 Lekë** në **3920 Lekë** në vit.

Taksa mbi ndërtesën- Taksa mbi ndërtesën është pjesë e taksës mbi pasurinë e paluajtshme. Çdo person fizik apo juridik, shtetas apo i huaj, i cili zotëron një pronë në territorin e Shqipërisë është subjekt i taksës mbi pasurinë e paluajtshme. Barra e kësaj takse bie mbi pronarin ose bashkëpronarin, në varësi të pjesës që secili zotëron. Baza e kësaj takse është sipërfaqja e ndërtimit në metra katrorë e pronës, mbi dhe nën tokë. Sipërfaqja e pronës përcaktohet sipas dokumentit përkatës mbi pronësinë. Të ardhurat e gjeneruara nga kjo taksë, i përkasin 100% bashkisë apo komunës në të cilën mbliidhet taksa.

Vlera e taksës: Sipas kategorive dhe nënkategorive vlera e taksës mbi ndërtesën varion nga **5 Lekë/m²** në **280 Lekë/m²**.

Taksa mbi Truallin- Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në m², në pronësi apo përdorim të tatimpaguesit. Vlera e taksës është si në tabelën më poshtë:

Tabela 7: Vlera e taksës mbi truallin

Taksa mbi truallin	Leke/m²/vit
Taksa mbi truallin për qëllime banimi nga individët	0,56
Taksa mbi truallin për qëllime biznesi	20

Burimi: Financat vendore

Taksa e Hotelit – Baza e taksës për akomodimin në hotel, llogaritet në bazë të çmimit të akomodimit, sipas rastit për person apo për dhomë. Kjo taksë mblidhet nga hoteli, në emër të bashkisë apo komunës, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Taksa e hotelit përcaktohet në çdo faturë të lëshuar, mbi çmimin përkatës për akomodim.

Niveli i taksës është si më poshtë:

Tabela 8: Vlera e taksës së Hotelit

Taksa e fjetjes në hotel	Lekë / netë
Hotelet me 4-5 Yje	140
Bujtinë, fjetinë, motel, dhe çdo njësi tjetër akomoduese	70

Burimi: Financat vendore

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja – Baza e taksës është vlera në lek (ALL) e investimit të kryer. Barra e taksës bie mbi investitorin, dhe mblidhet nga institucioni përgjegjës për dhënien e lejeve në emër të bashkisë apo komunës në të cilën do të kryhet investimi. **Përfshirje** nga kjo taksë bëjnë projektet infrastrukturore, ndërtimi i autostradave kombëtare, porteve, aeroporteve, tuneleve, ndërtimi i infrastrukturave energjetike, ku taksa e ndikimit në infrastrukturë përbën vetëm 0.1% të vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar.

Vlera e taksës: Niveli i taksës sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve varion nga **3% në 6% të vlerës së investimit.**

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë – kjo taksë aplikohet në të gjithë ndërtesat dhe pasuritë e paluajtshme në momentin e kalimit të së drejtës së pronësisë, nga një pronar në tjetrin. Taksa paguhet nga personi i cili kryen kalimin në momentin përpara regjistrimit të saj. Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë është sipërfaqja e ndërtesës së cilës i transferohet pronësia.

Tabela 9: Vlera e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	Lekë/m²
I. Ndërtesa banimi	300
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	700
III. Ndërtesa të tjera	500

Burimi: Financat vendore

Taksa e Tabelës – Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet të cilët vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime reklamimi. Niveli i kësaj takse përcaktohet nga Këshilli Bashkiak, dhe vlera e taksës nuk duhet të jetë më shumë se 10% e nivelit të taksës së biznesit të vogël.

Vlera e taksës: Vlera e taksës sipas kategorive të tabelave varion nga 120 lekë për m² në vit në 31.500 lekë për m² në vit.

4.3.3. Taksa e përkohshme për mbushje ose heqje dheu në sipërfaqen truall

Niveli i taksës për sipërfaqen e truallit që mbushet ose i hiqet dheu është **100.000 leke/dynym**. **Sikur niveli i taksës për gjatësinë në Km e infrastrukturës nëntokësore**, e cila vihet në shfrytëzim nga subjektet për qëllime biznesi, është **500 leke/m2**.

Taksa e Mjeteve të Përdorura të Transportit - Kjo taksë hyn në kategorinë e taksave kombëtare; barra e taksës i takon pronarit të mjetit sikur e ardhura nga taksa, për çdo rast, mblihdhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. **18 % e vlerës së grumbulluar njësisë vendore**, për mjetet që janë në territorin e saj.

Taksa e Rentës Minerare- Të gjithë personat fizikë ose juridikë, që janë të licencuar dhe veprojnë në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse është Drejtoria Rajonale Tatimore. Në rastin e eksportit të produkteve minerare, struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse janë Degët e Doganave në rrethe.

4.3.4. Tarifat vendore

Tarifa e shërbimeve publike (pastrimit dhe largimit të mbeturinave, gjelbërimit, ndriçimit dhe dekorit - Kësaj tarifë i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike ose jo brenda territorit të njësisë së qeverisjes vendore. Përgjithësisht kjo tarifë i referohet shërbimit të grumbullimit të mbetjeve të ngurta dhe pastrimit të rrugëve të qytetit.

Përfshihen nga pagesa e tarifës së shërbimeve:

- ❖ Familjet që kanë familjarin invalidë;
- ❖ Familjet që kanë në përbërjen e tyre të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë,
- ❖ Familjet që janë përfituese të ndihmës ekonomike;

❖ Pensionistët e vetëm ose me persona madhorë të papunë

Tabela 10: Vlera e tarifës mbi shërbimet publike

Tarifa e Shërbimeve Publike (Pastrimit dhe largimit të mbeturinave, gjelbërimit, ndriçimit dhe dekorit)							
Nr.	Kategoritë	Niveli i tarifës					
		Zona A		Zona B		Zona C	
		0-8 milion leke / vit	Mbi 8	0-8 milion	Mbi 8	0-8 milion	Mbi 8
I	Familjaret(për familje)	2700		2200		1800	
II	Biznesi						
II.1	Shitje me pakice	5.000 – 15.000	27.000 – 45.000	5.000 – 10.000	15.000 – 20.000	3.000 – 7.000	10.000 – 15.000
II.2	Shitje me shumice	15.000	37.000	10.000	20.000	7.000	15.000
II.3	Njësi prodhimi	5.000 – 25.000	42.000 – 47.000	5.000 – 10.000	20.000 – 30.000	3.000 – 12.000	15.000 – 20.000
II.4	Subjekte ndërtimi	5.000 – 30.000	30.000 – 100.000	5.000 – 20.000	15.000 – 70.000	3.000 – 15.000	10.000 – 50.000
II.5	Njësi shërbimi	500 -10.000	1.000 – 42.000	300 – 7.000	500 – 20.000	100 – 3.000	200 – 15.000
II.6	Shoqata, fondacione, organizata	10.000		10.000		10.000	
II.7	Ente të ndryshme shtetërore/leke/m2	100		100		100	
II.8	Profesione të lira	5.000	12.000 – 17.000	5.000	7.000 – 10.000	3.000	5.000 – 7.000
II.9	Ambulant	1.000		1.000		1.000	
II.10	Transport	2.000 – 5.000	15.000 – 22.000	2.000 – 5.000	7.000 – 10.000	2.000 – 3.000	5.000 – 7.000
II.11	Të tjera	5.000	10.000	5.000	7.000	3.000	5.000

Burimi: Financat vendore

4.3.5. Te ardhurat jo tatimore

1. Të ardhura nga qeratë e objekteve

Të ardhurat nga qeratë paguhen nga përfituesi dhe shfrytëzuesi i pronës në pronësi të bashkisë.

- Qeraja e tregut 250 lekë /m2/ muaj
- Qera objekte të rikonstruuar 300 lekë /m2/ muaj
- Qera objektet të parikonstruara 200 lekë /m2/ muaj

5. Të Ardhura nga Kopshtet dhe Çerdhet

Kjo tarifë paguhet nga familjarët e fëmijëve që marrin këtë shërbim. Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe arkëtimin e të ardhurave është Drejtoria e Financës.

6. Të Ardhura nga Privatizimi

Tarifa e shërbimit administrativ 3000/ lekë, për çdo aplikim Të ardhurat nga privatizimi paguhen nga përfituesi i pronës .

Gjobat

Një tjetër kategori e të ardhurave, janë edhe gjobat të cilat janë sipas kategorive të pasqyruara në tabelën 11.

Tabela 11: Lloji dhe vlera e gjobave në bashkinë Lezhë

Emërimi	Niveli i Gjobës
A. Gjoba për demtimet dhe ndërhyrjet ne infrastrukturën rrugore	15.000 – 20.000 leke
B. Gjoba për demtimet dhe nderhyrjet ne rrjetin elektrik rrugor	20.000 leke
C. Gjoba për demtimet dhe nderhyrjet ne rrjetin e ujësjellësit	20.000 leke
D. Gjoba për demtimet dhe nderhyrjet ne rrjetin e kanalizimeve te ujërave te bardha dhe te zeza / Gjobe për mos likuidim ne aftat te taksës se ndërtesës dhe tarifave te shërbimit publik	5.000 – 20.000 leke
E. Gjoba për dëmtim fasade	5.000 leke / m ²
F. Gjoba për demtimet dhe nderhyrjet ne hapësirat e gjelberta dhe ato publike	5.000 – 20.000 leke
G. Gjobe për hedhje te materialeve inerte ne vende te pamiratuara	3000 leke / m ³
H. Gjobe për mospajisje me leje për tregtim apo shërbim jashtë sipërfaqes se njërive	20.000 leke / rast

Burimi: Financat vendore

Faqe referuese:

<http://www.financatvendore.al/>

<http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti>

<http://www.instat.gov.al/al/themes.aspx>

https://www.bankofalbania.org/web/Statistika_230_1.php

<https://www.eda.admin.ch/albania>

<http://www.worldbank.org/en/country/albania>

<http://www.coe.int/en/web/tirana/home>

https://eeas.europa.eu/delegations/albania_en

<http://www.ippm.al/>

<http://ippm.al/lezha/>

<http://www.levizalbania.al/>